



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XXXIII-të (tridhjetetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 08 maj 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe filloi në orën 10;10

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: z.Florent Hasani, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkoll, ndërsa munguan znj.Qëndresë Hajrizi dhe z.Arbnor Fazliu

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Liman Zeqiri-shef i Zyrës Komunale për Komuniteteve dhe Kthim ZKKK; Driton Shabani nga Stacioni i Policisë në Podujevë; Bekim Karaxhija përfaqësues i OSBE; Zita Rasztik dhe Benjamin Bognar përfaqësues të KFOR-LMT; Fatlume Regjepi dhe Naile Ahmeti në cilësinë e pjesëmarrësve në mbledhje si qytetare nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj mirëseardhje në këtë mbledhje, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë, andaj në vazhdim po lexoj rendin e ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri me 6 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 08.04.2025

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali për ndonjë vërejtje gjatë diskutimit nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 6 vota Për, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 08.04.2025.

2. Informatë e Kryesuesit të Komitetit, në koordinim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, për vizitën në lagjen ku jetojnë komunitetet jo shumicë në qytet në rr.“Xhafer Meta” dhe vizitën në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova” në Podujevë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, ne e kemi vizituar shkollën “Dr.Ibrahim Rugova” në të cilën mësojnë shumica e nxënësve të komunitetit jo shumicë që jetojnë në rr.“Xhafer Meta”, ku aty kemi qenë prezent së bashku me shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri dhe znj.Shkurta Sejdiu anëtare e këtij Komiteti dhe kemi biseduar me drejtorin e shkollës si dhe me njërin prej mësuesve në këtë shkollë. Kemi parë nga afër si shkon puna apo si i'u shkon shkollimi atyre nxënësve, pastaj kemi biseduar edhe lidhur me vijimin e mësimi, vërejtjet në mësim si dhe për rastet të ndonjë braktisje të shkollimi. Pra të gjitha informacionet i kemi marr nga drejtori i shkollës dhe nga mësuesi i shkollës.

Po ashtu gjatë vizitës në shkollë, drejtori na ka informuar hollësisht lidhur me vijimin e nxënësve të komunitetit jo shumicë ku vërtetë është një kënaqësi ta shohësh atë klasë ku janë nxënësit e komunitetit jo shumicë se si zhvillohet mësimi në atë qendër/shkollë, pra mund të themi që është shembull jo vetëm për Komunë të Podujevës por edhe për komunat e tjera, edhe pse gjithherë çdo komunitet ka vështirësi, ndër to ishin mungesa e nxënësve që disa e vijnë mësimin e disa janë pranë braktisjes, por me ndihmën e Grupit që është i formuar, aty nuk ka braktisje, mungesa të nxënësve ka por braktisje për momentin nuk ka.

Problemi ishte tek nxënëset që kanë ardhur nga Komuna e Ferizajt kur ndodhi rasti i therjes me thikë nëse ju kujtohet para disa muajve, pra problemi është që ato vajza janë paksa edhe të sëmura e që kanë vijuar mësimin herë pas herë sa që njëherë ka qenë rrezik edhe ta braktisin por me vizitën që patëm ditën e djeshme po në atë shkollë na gëzoj fakti se ato nxënëse tani e vijnë mësimin, madje e kanë sjell një letër falënderuese te drejtori i shkollës që i'u është mundësuar të vazhdojnë mësimin, pra janë shumë të lumtura dhe të angazhuara për të vijuar mësimin dhe që ato orë të mësimi që i kanë humbur t'i kompensojnë. Pra këto informacione i kemi marrë dje gjatë vizitës që kemi bërë me shefin e ZKKK z.Liman dhe me përfaqësuesin e OSBE.

Problemi tjetër ishte te familja Behluli e cila është një familje bukur e madhe dhe janë një numër i konsiderueshëm i nxënësve nga ajo familje, them të drejtën këta nxënës janë më pak të shkolluar në krahasim me nxënës të tjerë, pra nëse e marrim më thellë këtë situatë nënkupton që familjarisht kanë shkollë më pak dhe kështu që fëmijët e tyre po ngecin në shkollim për arsye të ndryshme, ku shembull ata punojnë ndërsa disa prej tyre arsyetohen duke thënë që nuk kemi veshmbathje e gjëra të ngjashme, por drejtori i shkollës dhe mësuesi i tyre u kanë mundësuar atyre të cilët nuk kanë veshmbathje, ndërmjet një donatori i cili ka qenë i interesuar t'iu ndihmoj me veshmbathje,. Kështu që në përgjithësi unë mund të them se jam shumë i kënaqur që me të vërtetë aty nxënësit e vijnë mësimin dhe ka interesim nga ana e tyre, ndërsa tek dy qendrat tjera në shkollë nuk e di se si është gjendja e tyre, por në javët e ardhshme ose ndonjë ditë tjetër mund ta caktojmë që ta vizitojmë edhe dy shkollat tjera atë “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri”, më pastaj do të shikojmë gjendjen e nxënësve të komunitetit jo shumicë në këto dy shkolla.

Pra kjo ishte informata ime, por nëse edhe shefi i ZKKK z.Liman ka ndonjë gjë për të shtuar atëherë mund ta merr fjalën.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, falënderoj Kryesuesin e Komitetit për informatat e dhëna, vërtetë ne ishim në vizitë në shkollën “Dr.Ibrahim Rugova” për çka them se është edhe konstatim i OSBE e që vërtetë është mirë që ka konstatime të tilla nga Organizatat të tilla dhe që kemi mbështetje dhe bashkëpunim me vite të tëra dhe kjo neve na inkurajon që ata e konstatuan që kjo qendër që është aktive pra në shkollën “Ibrahim Rugova” është një prej qendrave më funksionale në rajon do ta quaja, por megjithatë ne e kemi parë edhe anën praktike të atyre nxënësve dhe kjo është që e kanë një mësim shtesë për ata nxënës që nuk kanë mundësi dhe aftësi në kuptimin e procesit të rregullt mësimor dhe kjo është mësimi shtesë që të konkretizohet për nxënien e diturisë. Pra duke i parë këto mundësi dhe mbështetjen e dhënë nga OSBE, ne e kishim takimin dhe ishte konstatim i tillë i të gjithëve neve, si dhe gjithashtu këtu implikohet edhe Drejtoria e Arsimit që i falënderoj për punën që e kanë bërë për këtë Qendër, dhe së bashku me drejtorin e kësaj Drejtorie kemi qenë aktiv për mbështetjen e këtyre si dhe mos braktisjen e mësimin në këtë shkollë. Andaj duke e parë që kjo shkollë ka numrin më të madh të nxënësve nga radhët e komuniteteve jo shumicë dhe duke marrë parasysh faktin që kjo shkollë funksionon jashtëzakonisht mirë për të gjithë nxënësit pa dallim ku të gjitha kabinetet funksionojnë e që po ashtu edhe drejtori i kësaj shkolle është një model për organizimin e procesit mësimor, por që shembull kemi edhe arsimtarin z.Adem Bajrami i cili angazhohet për mësim shtesë që me punët dhe suksesin e tij ka treguar precizitet dhe mirësjellje e që e ka ngritë nivelin e arsimit në nivelin më të mirë të mundshëm.

Ne si anëtar të Komisionit përkatës në kuadër të Komunës, kemi vizituar të gjitha shkollat, në SHFMU “Dr.Ibrahim Rugova”, me përpjekjen tonë dhe të DKA-së Komisioni për parandalimin e nxënësve por edhe me Kryesuesin e këtij Komiteti dhe me anëtarët tjerë kemi bashkëpunim edhe me Komisionin tjetër që është në kuadër të shkollës, por edhe me këshillin e prindërve ku kemi arrit që asnjë nxënës të mos i braktisë mësimet e shkollës së mesme të ulët që është obligim i këtij cikli shkollor. Në këtë shkollë janë 72 nxënës aktiv të komuniteteve jo shumicë që do të thotë janë në procesin e rregullt mësimor, përveç OJQ-së përkatëse që merret dhe ndihmon procesin mësimor e që tani kjo çështje është e mirë për neve por më e mira është që aty ka një ambient pa asnjë dallim, andaj kjo ka qenë ajo që neve na ka interesuar dhe jem mirënjohës që edhe më datë 18.04.2025 kemi qenë në vizitë bashkërisht dhe unë e them këtë që është një kënaqësi e mirë dhe shpresojmë që edhe në të ardhmen të kemi edhe suksese dhe të jetë një model i mirë i Komunës së Podujevës. Këtë e kanë konstatuar edhe OSBE që është modeli më i mirë ku nxënësit vijnë mësimet pa asnjë problem përveç atyre problemeve ekonomiko-sociale siç u cek familja Behluli e cila ka numrin më të madh të nxënësve që janë 8 nxënës që vijnë mësimet në atë shkollë dhe ne e dimë që edhe në numrin e banorëve të komuniteteve jo shumicë është familja më e madhe, por që edhe me ndihmën tonë kemi arritur që të gjithë t’i fusim në procesin mësimor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, e falënderoj parafolësin shef i ZKKK në Komunën e Podujevës për informatat e dhëna. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konstatoj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, rreth mundësive të realizimit të projekteve që ndikojnë drejtpërdrejtë tek komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, thirrjen e mbledhjes ia kam dorëzuar Drejtorisë në fjalë por pse nuk ka ardh askush prej kësaj Drejtorie nuk e di.

Ju njoftoj se unë kam biseduar me Kryetarin e komunës i cili më ka thënë që të gjitha projektet që i keni t'i diskutoni në Komitetin për Komunitete dhe të gjitha do t'i realizoj por vetëm duhet të sjellën me shkrim, prandaj ne sot këtu po diskutojmë dhe na duhet me shkrim t'i paraqesim të gjitha kërkesat dhe projektet pasi që nuk është prezent këtu drejtori i DSHPMShP.

Ne në lagjen ku banon komuniteti jo shumicë në rr."Ali Ajeti" kemi një problem të kah motshëm që është uji i pijes dhe gjatë diskutimit me Kryetarin e Komunës ai tha që ky projekt është zgjidh sepse e ka marrë përsipër Kompania e Ujësjellësit në Prishtinë dhe vetëm pritet fillimi i punimeve, por që njëherë për njëherë nuk kemi asnjë zhvillim, tash unë nuk e di por ju them se kjo është vetëm një informatë nga Kryetari i Komunës që më është thënë.

Pastaj në këtë rrugë është i domosdoshëm edhe asfaltimi, dhe kjo për shkak të punimeve kohë pas kohe në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjellësit, prandaj kjo rrugë ka nevojë për asfaltim si dhe për ndriçim në një pjesë të kësaj rruge e që ka qenë ndriçimi mirëpo me largimin e shtyllave më në atë pjesë nuk ka ndriçim.

Mandej në fshatin Sfeçël më parë është bërë me shkrim kërkesa për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, gjithashtu në fshatin Orllan z.Xhevdet Kovaçi na u është adresuar me kërkesë për rregullimin me kubëza të rrugës ku jetoj ai. Pra të gjitha këto kërkesa që i ceka janë për rr."Ali Ajeti" dhe në fshatrat Orllan dhe Sfeçël.

Ndërsa për kërkesat e banorëve të komuniteteve jo shumicë që jetojnë në rr."Xhafer Meta" e ka marrë përsipër anëtarja e këtij Komiteti znj.Shkurte Sejdiu që t'i paraqet të gjitha pasi që është edhe përfaqësuese e tyre në Komitetin për Komunitete, prandaj zonjës Sejdiu i takon që ta shqyrtoj gjendjen atje dhe të gjitha kërkesat e tyre të paraqiten me shkrim.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, kam biseduar me banorët e lagjes dhe ankesat e tyre ishin te rrjeti i kanalizimit i cili është në gjendje të rëndë sepse kundërmon shumë. Po ashtu asfaltimi i rrugës është bërë deri në gjysmë e jo në tërë lagjen, ndërsa kërkesë për shtëpi ka bërë znj.Edona Sejdiu dhe z.Ramiz Sejdiu. Te rr."Vëllezërit Frashëri" ku jetojnë familje të komunitetit jo shumicë, kërkesë e banorëve është rregullimi i shtratit të lumit aty afër sepse pas reshjeve të shiut po dëmtohen pronat private andaj këtë çështje si kërkesë e kemi deponuar në DSHPMShP, mirëpo nuk na është dhënë përgjigje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra sipas parafolësës kërkesat ishin për kanalizim, asfaltimi i rrugës, shtëpi banimi s dhe rregullim i shtratit të lumit.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të grupit të LVV-së, zotohem se këto kërkesa to i drejtojmë te Drejtoritë përkatëse dhe te Kryetari i Komunës, për realizimin e tyre në funksion të lehtësimit të jetës së banorëve të komuniteteve jo shumicë në lagjet e tyre ku jetojnë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin dhe mendoj se është mirë që ju asamblistët t'i merrni këto shënime dhe këto kërkesa dhe të njëjtat t'i paraqitni në Kuvend të Komunës duke kërkuar realizimin e tyre ngase lidhur me këtë nuk e di sa kemi të drejtë që këto kërkesa t'i paraqesim ne në Kuvend.

Zyrtari i Zyrës Ligjore dhe për punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Përhershme (Enis Sheholli), sqaroi se të drejtën për të paraqitur propozime dhe kërkesa të tilla në Kuvendin e Komunës normale se parashtrimi i kërkesave nuk mund të ndalohen për askënd dhe nga askush, mirëpo në rastin konkret duke i'u referuar pyetjes së Kryesuesit të Komitetit, sigurisht jeni në dijeni se buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2025 është miratuar në muajin shtator 2024 dhe ka pas një fazë të paraqitjes së kërkesave dhe nevojave nga ana e gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe jo vetëm përfshirë këtu edhe në emër të Komiteteve jo shumicë siç kanë qenë dëgjimet buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe dëgjimet për buxhetin e Komunës.

Gjithashtu nëse jeni në dijeni me funksionimin e Komitetit për Komuniste siç është përcaktuar në Legjislacionin në fuqi, ndër të tjera Komitetet e përhershme mund të dalin me konstatime të caktuara dhe në këtë rast mund të t'i rekomandojnë çështje të ndryshme Kuvendit të Komunës dhe Ekzekutivit të Komunës përfshirë këtu edhe Drejtorive apo edhe sektorëve të Komunës së Podujevës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, pajtohem me parafolësit, normalisht edhe me anëtarët e Komitetit dhe normalisht edhe me zyrtarin e zyrës ligjore, por gjatë diskutimit të kësaj pike do ishte mirë që prezent të ishte edhe drejtori i DSHPMShP sepse në këtë çështje pati më shumë për infrastrukturë, rrjet të kanalizimit dhe gjitha kërkesat tjera që u paraqiten për të gjitha lagjet dhe fshatrat ku jetojnë banorët e komunitetit jo shumicë.

Sa i përket asfaltimit të rrugëve kjo është kompetencë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM-së, ku këto kërkesa mund të shkojnë drejtpërsëdrejti në këtë Drejtori sepse ne e dimë që këta janë anëtarë të Komitetit për Komunitete por edhe të asamblesë komunale e që buxheti është miratuar, por që kërkesat janë më adekuate kur bëhen drejtpërdrejtë dhe normalisht për komunitete, mendoj që nuk është ndonjë barrë e madhe sepse ato kërkesa mund të realizohen pa asnjë problem.

Sa i përket kërkesave të banorëve që jetojnë te rr."Xhafer Meta" unë që merrem me statistika ju tregoj se në këtë lagje jetojnë 51 familje me 318 banorë dhe i kam të gjitha të dhënat tjera për secilën familje, përpos problemeve të cilat i paraqiti znj.Shkurte Sejdiu, çështja që është më e ndjeshme te këto komunitete është ajo socio-ekonomike apo papunësi që është një brengë dhe duhet ta kemi parasysh këtë sepse nuk mund të ketë mirëqenie sociale pa pasur punësim.

Elementi kryesor i njeriut është ajo si quhet edhe në Shqipëri prej asaj pakos së dhembshurisë skamjes apo çështjes sociale, ka shumë të rinj që kanë nevojë për punësim por këto janë çështje që nuk varen drejtpërdrejtë nga ne por ne duhet t'i bëjmë kërkesat dhe t'i kemi parasysh.

Ana tjetër që është si brengë është edhe çështja e banimit, kemi dy raste që kanë bërë kërkesë për banim mirëpo nuk kanë hapësirë/pronë si dhe ka pasë kërkesa për mbi ndërtim, dhe për të gjitha këto i kam shënimet e që janë 11 raste ku shumica e tyre kanë nevojë për rinovimin e shtëpive dhe po e ceku se kanë nevojë edhe për anën sanitare, e këto kërkesa ne në të ardhmen duhet t'ia adresojmë Qeverisë konkretisht Ministrisë për Komunitete dhe Kthim e cila e ka obligim këtë çështje ku disa herë ka bërë edhe ftesa publike për t'i ndihmuar komunitetet jo shumicë.

Po ashtu është edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e cila gjithherë ka hasë në probleme sa i përket dokumentacionit për legalizimin e pronave ku në shumë takime unë e kam ngritë këtë çështje dhe këtë e kanë paraparë që në një të ardhme shumë të shkurtë të legalizohen pronat sepse pa legalizimin e pronave është një hendek aty dhe nuk po mund ta rregullojnë dokumentacionin lidhur me kërkesat të cilat i quaj jetike që është banimi.

Ne e dimë që në bazë të shënimeve që kemi, është i nevojshëm ndërtimi dhe renovimi i shtëpive si dhe për mjete sanitare, infrastrukturë dhe punësim, unë mendoj që me përpjekjen tonë si ZKKK dhe të niveleve lokale duke filluar prej të gjitha digastereve që merren me këto çështje mendoj që duhet dhe do të realizohen këto kërkesa në një të ardhme sa më të shkurtë që të jetë e mundshme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësit për sqarimet dhe informatat e dhëna. Meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar edhe këtë pikët te rendit të ditës.

4. Të ndryshme

Nuk pati t lajmëruar për të marrë fjalën

Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0025414/25
Podujevë, 08 maj 2025**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**